



POLITIKAT NË FOKUS: Mundësitë në sektorin e Energjisë dhe Minerave në Kosovë

Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

'Politikat në Fokus' është publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë që ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat në vend. Ky edicion i këtij publikimi i kushtohet mundësive dhe potencialit në sektorët e Energjisë dhe Minerave në Kosovë, duke analizuar situatën aktuale dhe duke ofruar të dhëna për llojin e xeheve dhe burimeve që mund të gjenden në Kosovë, të cilat mund të ndihmojnë në përpjekje për zhvillim të përsheptuar ekonomik. Për këtë qëllim do të analizohen dy dokumentet kryesore që shërbejnë si kornizë për zhvillimin e sektorëve, gjegjësisht (1) Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, dhe (2) Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026.

Hyrje

Energjia dhe Minerat vazhdimisht janë theksuar si sektorë me potenciale të mëdha për Republikën e Kosovës. Kosova ka një numër të konsiderueshëm të burimeve natyrore që mund të shërbejnë për tërheqjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Megjithatë, lehtësisht mund të konkludohet se vendi nuk po arrin të gjejë përdorimin më të mirë të këtyre burimeve, prandaj nevojitet një qasje e re (dhe më dinamike) për të ndryshuar këtë trend.

Në literaturë mund të hasen shumë studime që tentojnë të analizojnë ndikimin e pasurive natyrore në rritjen ekonomike të një vendi. Rezultatet nga këto studime qartazi tregojnë

se vetë bollëku i burimeve natyrore nuk është i mjaftueshëm për këtë qëllim, dhe deri tani nuk është arritur ndonjë konsensus se a ka një shtet me pasuri të shumta natyrore përparësi të dukshme sa i përket arritjes së normave më të larta të rritjes së BPV-së. Në fakt, duke analizuar trendet e vendeve me pasuri të mëdha natyrore, ekonomistët kanë nxjerrë një term të ri: *mallkimi i burimeve*. Kjo për faktin se vendet me pasuri të shumta kanë treguar një trend më të ngadalshëm të rritjes ekonomike krahasuar me vendet që nuk njihen për pasuri natyrore¹. Ky paradoks tregon rëndësinë për hartimin e një strategjie të mirë dhe praktikave të shëndosha të zbatimit, për të gjetur përdorimin më të mirë të burimeve ekzistuese.

	Shteti	Vlera totale e burimeve	BPV për kokë banori (WB)
1	Rusia	\$ 75.7 trilion	\$ 8,748
2	SHBA	\$ 45 trilion	\$ 57,467
3	Arabia S.	\$ 34.4 trilion	\$ 20,029
4	Kanada	\$ 33.2 trilion	\$ 42,158
5	Irani	\$ 27.3 trilion	\$ 5,038
6	Kina	\$ 23 trilion	\$ 8,123
7	Brazili	\$ 21.8 trilion	\$ 8,650
8	Australia	\$ 19.9 trilion	\$ 49,928
9	Iraku	\$ 15.9 trilion	\$ 4,610
10	Venezuela	\$ 14.3 trilion	\$ 9,258

Tabela 1 Lista e shteteve me bollëk të pasurive natyrore

Siç kuptohet nga tabela e mësipërme, vetëm 3 nga shtetet që i përkasin listës së 10 shteteve më të pasura me burime natyrore kanë arritur një BPV për kokë banori më të lartë se \$40,000, përderisa shumica nuk e kalojnë pragun prej \$10,000. Kosova ka arritur

¹ Sachs dhe Warner, *Natural Resources and Economic Development: The curse of Natural Resources*, 2011

të krijojë një kornizë legjislative të mirë në këta sektorë, ndërsa mbetet të shihet shkalla se sa institucionet do të arrijnë të zbatojnë strategjitë kyçe në këta sektorë.

Sektori energjetik

Një furnizim i sigurve dhe i vazhdueshëm me energji elektrike është parakusht për zhvillim ekonomik të çdo vendi. Të gjithë sektorët ekonomik, përfshirë prodhimin, tregtinë apo shërbimet, kanë nevojë për energji si input drejt krijimit të vlerës së shtuar për produktet apo shërbimet e tyre. Për një kohë të gjatë pas përfundimit të luftës, mirëpo edhe pas shpalljes së pavarësisë, furnizimi me energji elektrike ka qenë një ndër pengesat më të mëdha në aspekt të zhvillimit të sektorit privat. Ndërprerjet e shpeshta dhe të paparalajmëruara të energjisë, cilësia e dobët e furnizimit dhe disa faktorë të tjerë kanë zvogëluar dukshëm kapacitetet e shumë ndërmarrjeve në Kosovë. Rrjedhimisht, në të shumtën e rasteve, sektori privat ka qenë i detyruar të mbështetet në mënyra tjera për të adresuar këtë problem (p.sh. duke investuar në gjeneratorë apo zgjidhje tjera për furnizim me rrymë). Furnizimi me energji elektrike është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit, edhe pse ende duhet punuar në këtë drejtim, veçanërisht për furnizimin e lokacioneve më larg qendrave urbane. Rishikimi i situatës së tanishme në sektor energjetik është i domosdoshëm për të shqyrtuar hapat e mundshëm për zhvillimin e sektorit.

Termocentralet

Kosova mbështetet në termocentrale me bazë linjiti për prodhimin e energjisë për të plotësuar shumicën e nevojave të energjisë elektrike në vend² Dy termocentralet e tanishme që përbëjnë 97% të prodhimit vendor të energjisë (Kosova A dhe Kosova B) janë ndërtuar në periudhën 1962-1984, dhe

rrjedhimisht, janë zhvlerësuar plotësisht duke tejkaluar jetëgjatësinë e tyre.

“Në 30 vitet e fundit nuk ka pasur kapacitete adekuate të reja gjeneruese të ndërtuara për të përcjellur kërkesën në rritje dhe për të mundësuar sigurinë e furnizimit. Aktualisht, pjesa dërmuese e njësisve gjeneruese janë në fund të jetës së tyre... Është e qartë se ekziston një nevojë urgjente për kapacitete të reja gjeneruese.”

Strategjia e Energjisë 2017-2026

Që nga atëherë, nuk ka pasur ndonjë investim të konsiderueshëm për kapacitete të reja energjetike, duke lënë të kuptohet se i gjithë vendi mbështetet në dy termocentrale të vjetra për të përbushur shumicën e nevojave të energjisë. Këto dy termocentrale kanë kapacitet të kombinuar prej mbi 1400 MW, mirëpo për shkak të vjetërsisë, kapaciteti operacional i tyre është 950 MW. Për më shumë, emetimet mjedisore të këtyre termocentraleve (veçanërisht të Kosova B) tejkalojnë në masë të madhe limitet dhe kriteret e vendosura nga Komisioni Evropian.

Prodhimi i energjisë ka treguar një trend në rritje në periudhën e pasluftës. Megjithatë, ky trend nuk është i qëndrueshëm pa ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Kosova vazhdon të importojë rreth 10-14% të energjisë elektrike për të përbushur kërkesën vendore për energji, veçanërisht gjatë orëve të pikut (ngarkesa maksimale). Shkalla e konsumit të energjisë ndryshon në mënyrë drastike gjatë periudhave të ndryshme të ditës (dhe në stinë të ndryshme). Prandaj, gjatë orëve të pikut kapacitetet aktuale nuk mjaftojnë për përbushjen e nevojave, ndërsa ka tepriçë të energjisë në periudha tjera gjatë natës. Për shkak të

² Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026*

veçorive teknike të termocentraleve ekzistuese, shkalla e prodhimit të energjisë nuk mund të ulet për të reflektuar kërkesën e vogël për energji gjatë kësaj periudhe. Edhe pse tarifata e energjisë elektrike janë dizajnuar në mënyrë të tillë që të inkurajojnë përdorimin e energjisë elektrike gjatë natës (pas orës 23:00), kjo politikë nuk ka arritur ndikimin e pritur tek konsumatorët. Duhet të theksohet se ka plane konkrete të bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë, veçanërisht për të gjetur një zgjidhje për kohën e pikut, përmes rezervave të fuqisë sekondare prej 25 MW, të prodhuara nga hidrocentralet në Shqipëri.

Duke pasur në konsideratë atë që u tha më lartë, nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të reja është urgjente. Përderisa investimi në burime të ripërtëritshme të energjisë është i dëshirueshëm dhe i nevojshëm, veçanërisht në kontekst të arritjes së kërkesave të BE, pjesa më e madhe e gjenerimit të energjisë duhet të vjen nga termocentralet me bazë linjitin. Kosova ka rezervat e 5-ta më të mëdha të linjtit në botë, dhe duhet të gjejë përdorimin më të mirë për këto rezerva. Planet për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re tashmë janë në faza të avancuara, dhe Qeveria së bashku me palët e tjera duhet të sigurohen se planet të zbatohen në përpikëri. Në të kundërtën, vazhdimi me termocentralet ekzistuese nuk është i qëndrueshëm, duke pasur në konsideratë vjetërsinë e tyre dhe kërkesën në rritje për energji elektrike. Gjithashtu, projekti i rehabilitimit të Kosovës B duhet të vazhdojë, në aspekt të investimit në komponent mjedisor, por edhe në pjesën e gjenerimit (pas ndërtimit të termocentralit Kosova e Re).

Një pjesë tjetër e rëndësishme në sistemin energjetik në vend është edhe komponenti i shpërndarjes dhe furnizimit. Kjo ka qenë pikë shqetësuese për shumë vite, si rrjedhojë e humbjeve teknike dhe komerciale në sistem (afërsisht 32%). Në vitin 2013, pjesa e shpërndarjes dhe furnizimit u privatizua, ndërsa në vitin 2014 sistemi i shpërndarjes dhe

i furnizimit janë ndarë ligjërisht për të funksionuar si dy ndërmarrje. Pas privatizimit është parë një trend pozitiv i rënies së humbjeve në sistem, veçanërisht sa i përket faturimit dhe mbledhjeve. Megjithatë, një pikë shqetësuese vijon të jetë veriu i Kosovës, ku deri tani nuk ka qenë i mundur faturimi i energjisë (rreth 5% të gjenerimit).

Në anën tjetër, Strategjia për Energji e Kosovës vlerëson sistemin e transmissioinit si hallkën më të shëndetshme të sistemit të energjisë elektrike në Kosovë, ku Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike përmendet si një shembull për kompanitë simotra të rajonit, përkundër vështirësive për të qenë pjesë e mekanizmave ndërkombëtar si rrjedhojë e pengesave politike.

Përmbledhje e sfidave për gjenerimin e energjisë përmes termocentraleve:

- TC ekzistuese shumë të vjetra
- Vonesa në investim në kapacitete të reja gjeneruese
- Humbje të mëdha jo-teknike
- Liberalizim me hapa të ngadalshëm
- Ndër-subvencionimi i tarifave
- Përdorim jo-efiçient i energjisë elektrike (për ngrohje të hapësirave)
- Dallime të mëdha në konsum gjatë 24 orëve
- Mbështetje e tepërt në importe për të mbuluar shpenzimet e pikut, si rezultat i kapaciteteve të limituara të energjisë alternative

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është institucioni kryesor për zhvillimin e politikave për funksionimin e tregut të energjisë në Kosovë. ZRRE ka për detyrë të publikojë tarifata e energjisë elektrike në baza vjetore për konsumatorë privat, komercial dhe industrial. Duke filluar nga data 1 prill 2017, ZRRE ka ndryshuar strukturën tarifore të

energjisë, në mënyrë që të largojë ndryshimet sezonale të çmimit të energjisë. Gjithashtu, tanimë ZRRE ka publikuar një numër të rregullave që kanë hapur rrugë liberalizimit të tregut të energjisë. Tre operatorë veçse janë licencuar sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo janë ende pasivë në treg. Një tjetër shqetësim të cilën bizneset kanë drejtuar në adresë të ZRRE është edhe subvencionimi i tarifave të konsumatorëve privat nga ana e konsumatorëve të biznesit, gjë që padyshim dëmton kompanitë private dhe ul konkurrueshmërinë e tyre.

Së fundi kemi qenë dëshmitarë të sfidave me të cilat Korporata Energjetike e Kosovës është ballafaquar për të pasur qasje në linjit (si rrjedhojë e vonësave në procedura të shpronësimit), ku është paraqitur një rrezik i madh për mungesë të energjisë si rrjedhojë e ndërprerjes së prodhimit. Duke pasur në konsideratë rezervat enorme të linjitet në vend, kjo çështje tingëllon tejet paradoksale. Institucionet qeveritare duhet të sigurohen që situata të tilla mos të paraqiten në të ardhmen. Gjithashtu, strategjia evidenton nevojën për të hapur një minierë të re të linjitet deri në vitin 2024, meqenëse rezervat e minierave aktuale do të shterohen deri atëherë.

Energjia termike

Përdorimi i rrymës për ngrohje të ambienteve është identifikuar si një sfidë për sektorin energjetik në vend, për shkak të ngarkesës së madhe në rrjetin e rrymës elektrike. Vetëm 3-5% e hapësirave gjatë dimrit mbulohe nga kompanitë rajonale të ngrohjes, përdërisa pjesa tjetër duhet të gjejnë alternativa tjera të ngrohjes. Kapacitetet e limituara të kompanive rajonale kanë kontribuar në këtë situatë e cila po ashtu kërkon adresim të mirëfilltë.

Projekti i kogjenerimit të energjisë termike përmes termocentralit Kosova B ka treguar potencial të madh për të përmirësuar situatën. Ky projekt ka mundësuar furnizim

stabil me energji termike për konsumatorët aktual në Prishtinë, dhe ka hapur rrugë për kyçjen e konsumatorëve të ri në sistem. Për momentin, ZRRE (që po ashtu mbikëqyr këtë sektor) ka zhvilluar një politikë për faturimin e konsumatorëve varësisht sipërfaqes së ngrohur, dhe jo duke u bazuar në konsum real të energjisë nga konsumatorët. Për momentin kompanitë rajonale të ngrohjes raportojnë humbje teknike prej rreth 18% në baza vjetore.

Sa i përket hapave të mëtutjeshëm, Strategjia Energjetike identifikon një numër të qëllimeve për të përmirësuar situatën e energjisë termike, si në vijim:

- Zgjerimi i rrjetit të Termokos në Prishtinë dhe komunat përreth në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht kogjenerimi përmes TC-ve.
- Ndërtimi i një centrali të ri për gjenerimin e energjisë termike në Gjakovë, si dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues
- Rehabilitimi i sistemeve të energjisë termike në Mitrovicë dhe Zveçan
- Ulja e humbjeve teknike në 8%
- Përgatitja e kushteve për ndërtimin e sistemeve të energjisë termike në 4 komuna të mëdha të Kosovës.

Siç u sqarua, për shkak të tendencës së qytetarëve për të përdorur rrymën për ngrohje të objekteve, çfarëdo reforme në këtë sektor do të ketë ndikime pozitive edhe në sektorin e energjisë elektrike. Megjithatë, përkundër potencialit të treguar nga projekti i kogjenerimit, procesi i zgjerimit të rrjetit në rajon të Prishtinës është duke u zhvilluar ngadalë. Një qasje më dinamike do të mundësonte një përfitim më të madh nga kogjenerimi, dhe do të ulte barrën në sistemin e energjisë elektrike. Gjithashtu, rehabilitimi i sistemeve të komunave tjera që veçse kanë një rrjet të tillë duhet të jetë prioritet.

Gazi Natyror

Përkundër ekzistimit të legjislacionit, i cili është në harmoni me direktivat e BE, Kosova nuk ka

infrastrukturë të gazit natyror. Zhvillimi i infrastrukturës për këtë burim të energjisë, i cili konsiderohet më "i pastër" se linjiti, paraqet një sfidë të madhe për Kosovën. Kosova së bashku me Shqipërinë kanë aplikuar për një projekt të përbashkët për gazin natyror (ALGOKAP) për t'u lidhur me gazsjellësin transatlantik. Ky gazsjellës pritet të jetë i gjatë 260 km, me kapacitet furnizues prej 2 miliardë m³. Ky projekt zë vendin e 7 në Listën e Projekteve me Interes për Komunitetin e Energjisë.

Kosova mbetet ndër shtetet e vetme që nuk është e lidhur në rrjetin evropian të gazit natyror.

Burimet e Ripërtërithme të Energjisë

Si shtet nënshkruar në Komunitetin Evropian të Energjisë, Kosova ka marrë përsipër disa përgjegjësi sa i përket zbatimit të masave për efikasitet të energjisë, përdorimit të BRE dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kosova ka potenciale të konsiderueshme për përdorimin e burimeve të ripërtërithme të energjisë, si burim sekondar i energjisë në vend. Fatkeqësisht ky sektor është jo aq i zhvilluar në vend, dhe rrjedhimisht Kosova mbështetet në import të energjisë për mbulim të nevojave gjatë intervaleve të ditës. Vendi është ballafaquar me sfida të shumta në tërheqjen dhe mundësimin e investimeve në këtë fushë, përkundër ekzistimit të infrastrukturës ligjore.

Si nënshkruese e Traktatit për Komunitet të Energjisë, Kosova obligohet që të arrijë një përqindje të caktuar të energjisë së BRE në konsumin e përgjithshëm të energjisë deri në vitin 2020. Plani Kombëtar i vendos Kosovës

një cak prej 25%, ndërsa një Udhëzim i brendshëm Administrativ (UA 01/2013 i MZHE) ka vendosur një cak edhe më të lartë rreth 29.47% (për momentin pjesëmarrja është rreth 20%). Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar për energji nga BRE në Kosovë në fund të vitit 2017 parashihet të jetë 99.5 MW, shifër kjo që pritet të arrijë vlerat mes 401-470 MW deri në vitin 2026.

Duke pasur parasysh trendet në këtë sektor, ky projektim duket shumë ambicioz, meqenëse për arritjen e tyre duhet një normë mesatare e rritjes prej 20% përgjatë periudhës sa i përket energjisë së gjeneruar nga BRE.

Për të inkurajuar përdorimin e BRE, Kosova përmes Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka zhvilluar një skemë mbështetëse të tarifave "feed-in" për energjinë nga uji, era, energjinë fotovoltaike dhe biomasën. Këto tarifa mund të ndryshohen në baza vjetore nga ZRRE.

Tarifat "feed-in" për energji nga BRE:

Hidrocentralet e vogla: 67.47 €/MWh

Energjia e erës: 85.00 €/MWh

Energjia nga biomasa: 71.30 €/MWh

Energjia fotovoltaike: 136.40 €/MWh

Për më shumë, KOSTT dhe sistemi i shpërndarjes janë ligjërisht të obliguar t'i japin përparësi energjisë së gjeneruar nga BRE, sipas limiteve të specifikuar me Kodin e Rrjetit. Operatori i tregut poashtu është i obliguar të blejë energjinë e prodhuar nga BRE me tarifën e përcaktuar "feed-in".

BRE (në MW)	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Fotovoltaike	2	6	8	10	11	12.5	15	18	22	26.5
Biomasa	2	4	4	5	7	7	9	9	11	11
Energjia e Erës	1.5	35	62	70	110	110	120	120	130	130
HC e vogla ekzistuese	74	74	74	74	74	74	74	74	74	74
HC të reja të vogla	20	91	100	107	110	110	120	120	140	160
Total	99.5	210	248	266	312	313.5	338	341	377	401.5

Tabela 2 Projektimet për kapacitete të gjenerimit të energjisë nga BRE për periudhën 2017-2026

Në mënyrë që të mundësohet arritja e synimeve të shprehura, institucionet duhet të rrisin përpjekjet e tyre në mënyrë të ndjeshme. Ekzistimi i tarifave "feed-in" është një faktor inkurajues, por nuk siguron arritjen e rezultateve. "Kushtet për kyçje në rrjet, procedurat administrative (kontratat, licencat, lejet, burokracitë e pa koordinuara të shumëfishta, etj.) dhe shkalla e stabilitetit e mekanizmit mbështetës janë gjithashtu relevante."³

Për momentin ekzistojnë 4 HC operationale në territor të Kosovës, 3 nga të cilat të lidhura në rrjetin shpërndarës (me kapacitet të përbashkët prej 2.76 MW), ndërsa 1 në sistem të transmisionit (me kapacitet 8.08). Përveç këtyre, HC Ujmani gjithashtu kontribuon në sistemin elektrik me kapacitet të instaluar prej 35 MW, dhe prodhim vjetor prej afro 90 GWh. Në vitin 2011, është komisionuar një hidrocentral i vogël me kapacitet 3.89 MW, ndërsa në vitin 2016 janë ndërtuar dy HC, njëra me kapacitet 9.2+8.4 MW, ndërsa tjetra me kapacitet 4.3 MW. ZRRE ka njoftuar se ka lëshuar leje finale të autorizimit për kapacitet prej 76 MW, leje paraprake të autorizimit për kapacitet prej 89 MW, si dhe është në proces të shqyrtimit të kërkesave për autorizim për 513 MW shtesë.

Gjeneratorët e parë të energjisë nga era u instaluan në vend në vitin 2009, me kapacitet prej 1.35, ndërsa në ndërkohë ZRRE ka njoftuar se ka pasur kërkesa të reja nga kompani për zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese në lokacione tjera në Kosovë. ZRRE ka lëshuar leje të autorizimit paraprak për kapacitet prej 87.75 MW dhe është në proces të shqyrtimit për 51 MW tjera.

Strategjia flet shumë pak për panele solare dhe energji fotovoltaike, përkundër se ka pasur interesim të shtuar në mesin e bizneseve për të investuar në këtë fushë. Megjithatë, vlerësohet se kapaciteti për

gjenerim të energjisë nga ky burim në Kosovë është afërsisht 1500-1650 kW/m².

Efiçienca e energjisë dhe mbrojtja e ambientit

Kosova ka aprovuar një Ligj mbi Efiçencën e Energjisë në vitin 2012, së bashku me një numër të akteve nënligjore që adresojnë çështje specifike në këtë temë. Për më shumë, ligji ka hapur rrugën për krijimin e Agjencisë së Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe Komisionit Certifikues të Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë. Kjo çështje sqarohet në Strategjinë Energjetike të Kosovës në këndvështrim të zotimeve drejt standardeve dhe kriterëve të BE. Megjithatë, krahas kësaj duhet theksuar se efiçienca e energjisë është e rëndësishme edhe në aspekt të zhvillimit ekonomik, në kontekst të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve ekzistuese të gjenerimit.

Plani i Veprimit për Efiçencë të Energjisë në Kosovë për periudhën 2010-2018 parasheh kursime deri 9% apo 92 Ktoe (kiloton ekuivalent nafte). Gjithashtu, 27 komuna në Kosovë kanë zhvilluar plane për efiçencë të energjisë, që kontribuojnë në përpjekjet e përgjithshme për arritjen e caqeve të caktuara. Kjo fushë ka marrë vëmendje të veçantë edhe nga shumë organizata donatore, qoftë në aspekt të ofrimit të ekspertizës teknike mbi fusha të caktuara, apo duke financuar investime në funksion të këtij qëllimi. Megjithatë, ende ka shumë hapësirë për të rritur vetëdijen mes bizneseve dhe konsumatorëve privat të energjisë mbi këtë temë. Ka shumë projekte të ndryshme (që kryesisht mbështeten nga donatorë), që lehtësojnë qasjen në financa për NVM-të e Kosovës që kanë plane për të investuar në efiçencë të energjisë.

Në arritjen e caqeve për efiçencë të energjisë, Strategjia Energjetike e Kosovës parasheh edhe themelimin e Fondit për

³ Sefa dhe Rexha, *Sfidat e padiskutuara për zhvillim të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë*, 2013

Efiçencë të Energjisë, në bashkëpunim me institucione financiare dhe në harmoni me praktikat më të mira. Ky fond do të përdorej jo vetëm për të financuar aktivitetet për rritjen e efiçencës në mesin e institucioneve publike, por edhe për NVM-të dhe konsumatorët privat. Vlen të theksohet se pas vitit 2018, Komuniteti Energjetik do të vendosë caqe të reja për efiçencë të energjisë, dhe politikat e tilla si fondi, mund të lehtësojnë arritjen e këtyre caqeve.

Sa i përket ndikimeve mjedisore të sistemit energjetik të tanishëm në vend, duhet të shikohen emetimet e tanishme nga termocentralet në këndvështrim të standardeve dhe kritereve të vendosura nga BE, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme. Siç shihet, emetimet nga termocentralet (veçanërisht nga Kosova B) në masë të madhe tejkalojnë kriteret e Bashkimit Evropian mbi këtë çështje, kështu duke nënvizuar nevojën urgjente që të investohet në kapacitete të reja gjeneruese, që patjetër do të prodhonin rezultate më të mira mjedisore.

Strategjia e Energjisë së Kosovës gjithashtu liston një numër të aktiviteteve që duhet ndërmarrë nga institucionet për të arritur qëllimet për uljen e ndikimeve negative në mjedis si rezultat i aktiviteteve në fushën e energjisë, gjegjësisht:

- Kompletimi i legjislacionit në harmoni me *EU Acquis*, dhe implementimi i duhur i legjislacionit
- Aprovimi i planeve për uljen e emetimeve

- Përdorimi i burimeve (si linjiti) në përputhje me zotimet ndërkombëtare të dala nga MSA dhe traktati i energjisë.
- Hartimi i master planit për rehabilitimin mjedisor të minierave të qymyrit etj.

Sektori minerar

Shumë palë të ndryshme të interesit kanë identifikuar sektorin minerar si një ndër prioritetet kryesore në diskutime për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Ky sektor vlerësohet se ka potencial të jashtëzakonshëm, për shkak të bollëkut të një numri të xeheve që mund të eksploatohen për të arritur norma më të larta të rritjes. Zhvillimi i sektorit minerar në Kosovë është i lidhur ngushtë me kompleksin minerar Trepça, si një shtyllë kyçe e industrisë, që tani ballafaqohet me sfida enorme që ndikojnë në potencialin e saj.

Burimet natyrore i referohen elementeve dhe substancave siç janë mineralet, pyjet, ujërat dhe toka e punueshme, të cilat gjinden në natyrë dhe mund të përdoren për përfitim ekonomik. Megjithatë, në kuptim të sektorit minerar, diskutimi do të fokusohet në eksplorimin dhe shfrytëzimin e burimeve minerale.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik është institucioni kryesor që ka për detyrë zhvillimin e politikave dhe strategjive për këtë sektor. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale gjithashtu ka një rol tejet të rëndësishëm, në aspekt të dhënies së lejeve dhe licencave për eksplorim dhe shfrytëzim për operatorë ekonomik.

Termocentrali	Pluhur(mg/Nm ³)		SO ₂ (mg/Nm ³)		NO ₂ (mg/Nm ³)		CO ₂ (mg/Nm ³)	
	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014
TC Kosovo A	44	57	289	418	725	714	259.67	262.91
TC Kosovo B	645	860	327	511	821	814	220.7	216.04
Kriteret e BE	50		40		500			

Tabela 3 Ndikimi në mjedis i dy termocentraleve ekzistuese

Ngjashëm si në sektorin energjetik, edhe investimet në sektorin mineral nuk kanë arritur vlerat e pritura.




Tabela 4 Kontributi i aktiviteteve minerare në BPV

Siç pasqyrohet, kontributi i përgjithshëm i aktiviteteve minerare dhe nxjerrjes së xeheve në Bruto Produkt Vendor është shumë i ulët⁴, me tendencë të rënies së mëtutjeshme. Ky është një tregues i qartë se vendi nuk po arrin të shfrytëzojë më së miri burimet natyrore në dispozicion. Revitalizimi i industrisë minerare padyshim se nuk i thjeshtë, dhe për këtë nevojiten investime të shumta nga sektori privat. Prandaj, edhe politikat publike duhet të reflektojnë këtë nevojë, dhe duhet të zhvillohen në këndvështrim të nxitjes së investitorëve për të shqyrtuar Kosovën si destinacion të mundshëm për investimet e tyre.

Në këtë kontekst, sektori privat ka ngritur një numër të sfidave në sektorin mineral. Adresimi i sfidave të paraqitura më poshtë nga institucionet përkatëse, padyshim se do t'i hapte rrugë rritjes së investimeve në sektor:

- Fillimisht, kompanitë në këtë sektor ankohen për procedura të tej zgjatura burokratike, që cenojnë investimet e

sektorit privat. Në mënyrë që të merret një leje për shfrytëzim apo eksplorim, kompanitë duhet të dorëzojnë një sërë të dokumenteve në adresë të institucioneve të ndryshme, dhe të presin për përgjigje ndarazi në secilin rast. Një vonesë në cilëndo hallkë të procesit mund të shkaktojë vonesa të mëdha në tërë projektin, dhe shpeshherë investitorët ankohen për këto procedura që rrisin barrën financiare dhe shkaktojnë humbje kohe. Oda Amerikane për disa vite ka kërkuar që KPMM të shërbejë si dritare e vetme (one-stop-shop) për gjithë investitorët në këtë fushë, si pikë e unike e kontaktit gjatë aplikimit për leje të eksplorimit apo shfrytëzimit. Megjithatë, një kërkesë e tillë asnjëherë nuk është realizuar.

- Krahas çështjes së sqaruar më sipër, KPMM për një kohë të gjatë nuk ka qenë funksionale, si rrjedhojë e vonesave në emërimin e bordit udhëheqës. Për momentin, ky problem është zgjedhur, por institucionet duhet të sigurohen që probleme të tilla mos të paraqiten në të ardhmen.
- Procedurat e komplikuar të shpronësimit mbesin shqetësim madhor për investitorët në këtë fushë. Ligji i Minerave dhe Mineraleve parasheh që në rastet kur investitorët e kanë të pamundur të arrijnë marrëveshje me pronarin e tokës, përkundër ofrimit të kompensimit adekuat, KPMM mund të fillojë procedura të shpronësimit. Megjithatë, raportohet se kjo dispozitë rrallëherë përdoret dhe investitorët hasin




Tabela 5 Procedurat për marrjen e lejes për shfrytëzim

⁴ Të dhënat e nxjerra nga faqja zyrtare e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

vështirësi në gjetjen e gjuhës së përbashkët me pronarë të tokave.

- Për shkak të numrit të madh të licencave dhe numrit të madh të institucioneve të përfshira, mundësia për prezencën e korrupsionit është më e madhe. Në fakt, një e gjetur e tillë është elaboruar në një raport të UNDP. Megjithatë, institucionet e fushës e kanë kontestuar këtë të gjetur.

Sa i përket çështjes së parë të sqaruar më lartë, vlen të theksohet se në fillim të vitit 2017, Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës. Investimet në sektorin e energjisë dhe minierave që arrijnë vlerën prej të paktën 30 milionë euro do të përfitojnë trajtimin e investimit strategjik. Sipas ligjit, disa nga përfitimet kryesore për investitorët strategjikë janë:

- ndihmë në procedurat administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve pranë institucioneve publike;
- ndihmë në kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve që nevojiten për fillimin e procedurave administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve;
- procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesave të cilat ndërlidhen me përgatitjen dhe zbatimin e projektit strategjik⁵

Pra, nëse ligji zbatohet si duhet dhe mekanizmat mbështetës funksionojnë në mënyrë të mirëfilltë, kjo mund të ndihmojë në nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në sektorin minierar. Megjithatë, institucionet ende janë në proces të hartimit të legjislationit sekondar të këtij ligji, për t'i hapur rrugë zbatimit të tij. Mbetet të shihet se a do t'i arrijë qëllimet e proklamuarra ky ligj.

Burimet Natyrore në Kosovë

Siç u përmend shkurtimisht në pjesët e mëhershme të këtij publikimi, burimi natyror kryesor që Kosova ka me bollëk është linjiti, i cili përdoret për prodhimin e 97% të energjisë elektrike në vend. Kosova ka 3 basene kryesore të linjtit, të cilat përmbajnë mbi 12 miliardë ton linjit. Megjithatë, predispozitat gjeologjike sugjerojnë se ky burim mund të gjendet në bollëk edhe në pjesët tjera të territorit të Kosovës.

Baseni i qymyrit	Sasia (tonelata)
Baseni i Kosovës	10.1 miliardë
Baseni i Dukagjinit	2.2 miliardë
Baseni i Drenicës	0.1 miliardë
Totali	12.4 miliardë

Tabela 6 Basenet kryesore të linjtit në Kosovë

Sipas një studimi të zhvilluar mbi shfrytëzimin e linjtit në Kosovë, kostoja mesatare e nxjerrjes së tij është rreth 7.8 deri 11 €/ton, ndërsa nga viti 2012, renta minerare për eksploatinin e linjtit është 3 €/ton. Bazuar në ritmin e deritanishëm të shfrytëzimit të linjtit, lehtësisht mund të konkludohet se Kosova ka linjit të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e gjenerimit të energjisë elektrike për qindra vite.

Përpos përdorimit të këtij burimi natyror për qëllime të energjisë elektrike përmes termocentraleve, ka pasur diskutime për shfrytëzim në projekte tjera (p.sh gazifikimi nëntokësor i qymyrit). Megjithatë, deri tani projekte të tilla nuk janë materializuar, duke nënvizuar kështu nevojën për krijimin e lehtësirave në këtë sektor.

Përpos linjtit, Kosova është e pasur edhe me disa burime tjera minerale, në veçanti me Zink, Plumb, Argjend, Nikel, Krom, Kobalt, Bakër, Magnez etj. Megjithatë, vështirësitë me të cilat Trepça nën Administrimin e AKP-së është ballafaquar (shumë nga të cilat vazhdojnë ende) kanë dëmtuar në masë të madhe potencialin e Kosovës për valorizimin e pasurive të tilla. Problemet të cilat

⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, 2017

ndërmarrja ka pasur në veprimtarinë e saj, qofshin ato të natyrës politike, apo si rezultat i pretendimeve të kreditorëve, kanë cinguar në vazhdimësi potencialin e Trepçës. Megjithatë, problemet e Trepçës janë shumë më të gjëra dhe më komplekse për t'u trajtuar në këtë publikim. Vlen të theksohet se për shkak të rrezikut të likuidimit dhe falimentimit, në vitin 2016 Kuvendi i Kosovës nxjerri një ligj për Trepçën, në mënyrë që ndërmarrja të shndërrohet nga një ndërmarrje shoqërore në ndërmarrje publike, ku Qeveria është aksionari kryesor (80% të aksioneve). Gjithashtu, në vitin 2017 AKP i dorëzoi Qeverisë një studim të fizibilitetit për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes. Pavarësisht kësaj, situata rreth Trepçës vazhdon të krijojë shumë paqartësi për hapat e mëtejshëm.

Sa i përket burimeve si zinku, argjendi, plumbi dhe mineraleve tjera, është vështirë të vlerësohet sasia e pranishme në territorin e Kosovës. Megjithatë, ka vlerësime të përgjithshme për praninë e këtyre mineraleve në një numër të minierave në brezin metalogjenik Trepça, siç shihet në tabelën e mëposhtme. Përpos këtyre mineraleve, xehet përmbajnë edhe një numër të mineraleve tjera në sasi më të vogël, duke përfshirë: arin, selenin, bizmuthin etj. Renta minerare për argjendin është 5% e të hyrave korporatave të gjeneruara nga shitja e xehes, ndërsa renta minerare për plumb dhe zink është 4.5%.

Nikeli dhe kobalti janë dy minerale tjera metalike që mund të gjenden në territorin e Kosovës. Faktikisht, eksportuesi më i madh në

Kosovë, NewCo Ferronikeli, ka dy miniera me shfrytëzim sipërfaqësor të Nikelit. Rezervat gjeologjike në të dy minierat janë vlerësuar rreth 13 Mt, me përmbajtje nikeli prej 1.31%, dhe përmbajtje të kobaltit prej 0.06%. Renta minerare për shfrytëzimin e nikelit apo xeheve nikeli-kobalt është 4.5%. Disa minerale tjera metalike që mund të gjenden në Kosovë janë boksitet, xehet hekur-nikel, kromi, magnezi etj.⁶

Një numër i materialeve të përdorura në industrinë ndërtimore mund të gjenden në territorin e Kosovës (rentat minerare përkatëse të shënuara në kllapa):

- Shkëmbinj të fortë silikatë (1.00 €/m³)
- Shkëmbinj të fortë karbonikë
- Zhavorri (1.25 €/m³)
- Rëra kuarcore (4.00%)
- Mergelët për çimento (0.60 €/m³)
- Gurët dekorativë dhe dimensionalë (3.20%) etj.

Strategjia Minerare e Kosovës 2012-2025

Strategjia Minerare e Kosovës 2012-2025 ka për synim të shërbejë si dokument kornizë për zhvillimin e këtij sektori në vend. Kjo strategji fillimisht përmend një numër të institucioneve që kanë një rol të rëndësishëm në ekosistemin minierar në vend, dhe rrjedhimisht cakton 4 shtylla kryesore që shërbejnë si bazë për ndërtimin e strategjisë.

Secila nga këto shtylla përmban një numër të qëllimeve dhe masa konkrete për arritjen e tyre. Sa i përket shtyllës së parë, qëllimet përfshijnë kompletimin e bazës ligjore, hartimin e politikave për zhvillimin e

Vendi	Ton i xeheve	Plumb (Pb)		Zink (Zn)		Argjend (Ag)	
		%	ton	%	Ton	g/t	kg
Stanterg	35,081,000	3.85	1,349,579	3.85	1,080,504	65.0	2,280,224
Cernac/BB/Gom	7,544,227	6.85	516,645	5.07	382,373	96.13	725,256
Compl. Artane	16,037,227	4.67	749,354	6.52	1,045,444	89.91	1,441,879
TOTAL	58,662,569	4.46	2,615,578	4.28	2,508,321	75.81	4,447,359

Tabela 7 Prania e vlerësuar e plumbit, zinkut dhe argjendit në Minierat e Trepçës

⁶ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025*

sektorëve, zhvillimin e politikave fiskale që nxisin investime (renta minerare të përshtatshme), dhe realizimi i rivlerësimit ekonomik të potencialit mineral.

Shtyllat e SMK 2012-2025:

1. Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve.
2. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe Institucionale në sektorin mineral
3. Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit
4. Përkujdesja për mjedisin

Në anën tjetër, shtylla e dytë përmban qëllim mbi ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale dhe eksplorimin e potencialeve të reja minerare përmes zhvillimit të programeve të hulumtimit dhe të ngjashme.

Duhet të theksohet se me qëllim të lehtësimit të zbatimit të strategjisë, MZHE ka hartuar një Plan për Zbatimin e Strategjisë Minerare të Kosovës për periudhën 2015-2017 si dhe ka publikuar disa plane për shkallën e shfrytëzimit të burimeve minerale.

Konkluzionet

Sektorët e energjisë dhe minerave padyshim se kanë potencial të madh për të kontribuar në arritjen e synimeve për zhvillim ekonomik, mirëpo për momentin ky potencial nuk po shfrytëzohet sa duhet. Siç u sqarua, vetë ekzistimi i burimeve natyrore nuk garanton zhvillim ekonomik, pa pasur një kombinim të favorshëm të politikave. Që të dy sektorët kanë nevojë për investime të mëdha, si për rehabilitimin dhe përditësimin e objekteve ekzistuese, ashtu edhe për ndërtimin e

kapaciteteve të reja. Gjenerimi i investimeve në këta sektorë ka qenë shumë i vështirë, dhe një pjesë e madhe e fajit i është lënë kërkesave strikte legjislative dhe burokracisë së tepërt procedurale. Tani, me zbatim të mirëfilltë të Ligjit për Investime Strategjike, institucionet përgjegjëse mund të zhvillojnë një qasje më fleksibile për nxitjen e investimeve në këta sektorë.

Përveç nevojës për të nxitur investime në burime të ripërtëritshme të energjisë, procesi për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re duhet të vazhdojë, si burim parësor i furnizimit me energji elektrike. Teknologjitë e reja mundësojnë një përdorim më të pastër dhe miqësor ndaj mjedisit të linjtit, që paraqet pasurinë më të madhe natyrore të Kosovës. Krahas kësaj, masat për rritjen e eficiencës së energjisë duhet të vazhdojnë, në mënyrë që Kosova të arrijë caqet e caktuara nga Bashkimi Evropian.

Sa i përket burimeve minerale, pritet të shihet se si do të zhvillohet situata rreth kompleksit mineral Trepça. Ligji për Investimet Strategjike, që ndër synimet kryesore e ka nxitjen e investimeve në këtë sektor, ka hapur një dritare të re të mundësive për Kosovën, dhe me shpresë do të mundësojë arritjen e rezultateve më të kënaqshme sa i përket nxitjes së investimeve në sektorin privat.

Listë e shkurtesave

ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
HC	Hydrocentral
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
MW	Megavat
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
SMK	Strategjia Minerare e Kosovës
TC	Termocentral
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Literatura

Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2017. Llogaritë Kombëtare: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike. Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2010. "Ligji Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale." Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Gusht 27.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2016. "Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë." Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Korrik 13.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2016. "Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë." Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Korrik 14.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2016. "Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike."

Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Korrik 21.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2017. "Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës." Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Shkurt 8.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik. 2012. "Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025." Prishtinë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik. 2017. "Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2026." Prishtinë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Mars.

Sachs, Jeffrey D, dhe Andrew M Warner. 2001. "Natural Resources and Economic Development: The curse of natural resources." European Economic Review 45 827-838.

Sefa, Ruzhdi, dhe Blerim Rexha. 2013. "Sfidate e padiskutuara për zhvillim të burimeve të ripërtërishme të energjisë në Kosovë." Prishtinë, Tetor.